

| |
|--|
| REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA |
| REPUBLIC OF KOSOVO |
| QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA |
| MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE |
| MINISTRY OF JUSTICE |
| Nr.Br.Nat: 01-30494 |
| Data/Datum/Date: 22/10/2018 |
| Shtoja/Dodaci/Annex: -4- |
| PRISHTINË/A |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

MINISTRIA E DREJTËSISË – MINISTARSTVO PRAVDE – MINISTRY OF JUSTICE
DEPARTAMENTI PER PROFESIONE TE LIRA

Komisioni Disiplinor / Disiplinska Komisija / The Disciplinary Comitee

Nr. 12/2018

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Bajram Miftari-kryesues, Mahir Tutuli-anëtar dhe Fadil Hoxha - anëtar, në çështjen juridike disiplinore të përmbaruesit privat [REDACTED] i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1, pika 1.2 i LPP-së; pas përfundimit të seancës dëgjimore të datës 18.10.2018, ku ishin të pranishëm: përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës - Departamenti për Profesione të Lira, Labinot Gashi, në cilësinë e propozuesit për fillimin e procedurës disiplinore; personalisht përmbaruesi privat, në cilësinë e të dyshuarit për shkelje disiplinore; dhe pala ankuese K.S. "INSIG", në seancën për këshillim dhe votim, të datës 18.10.2018, duke vendosur me shumicë votash, mori këtë:

V e n d i m

- I. Z. [REDACTED] përmbarues privat i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ËSHTË PËRGJEGJËS për shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, e përshkruar si në propozimin e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, të paraqitur me datën 30.08.2018.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbaruesit privat z. [REDACTED] i shqiptohet masa disiplinore "gjobë në të holla", në shumën prej 1,000 € (Njëmijë Euro); e paraparë me nenin 368, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
- III. Detyrohet përmbaruesi privat, z. [REDACTED] që të bëjë pagesën në emër të gjobës së shqiptuar me këtë vendim, në llogarinë bankare të buxhetit të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej një muaji, duke e llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij vendimi, përmbaruesit privat.

A r s y e t i m i

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (në vazhdim të tekstit: Ministria), me datën 30.08.2018, ka paraqitur propozim për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat [REDACTED] emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkak të dyshimit të bazuar se ne lëndët përmbarimore të udhëhequra pranë zyrës së tij, P.nr.251/17 dhe P.nr.24/18, ka kryer shkelje disiplinore nga neni 367, paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së. Në propozim ndër të tjera është theksuar se përmbaruesi privat në zbatimin e përmbarimit në lëndët përmbarimore të sipërmendura ka inkasuar kamata në norma më të larta se kanë qenë të parapara me aktgjykimet si tituj përmbarimorë.

Me datën 18.10.2018, është mbajtur seanca dëgjimore pranë Komisionit, ku kanë qenë të pranishme të dy palët në procedurë. Në seancë është paraqitur po ashtu edhe pala ankuese K.S “INSIG”, e cila ka paraqitur opinionin e saj përkitazi me këtë çështje.

Në seancën dëgjimore të mbajtur, përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore dhe i ka propozuar Komisionit që përmbaruesi të shpallet përgjegjës për shkelje disiplinore. Nga ana tjetër, përmbaruesi privat ka dekluar gjatë seancës se nuk e pranon përgjegjësinë disiplinore, siç është shtjelluar në propozimin për fillimin e procedurës disiplinore. Ka theksuar më tutje se me propozimet për caktim përmbarimi në lëndët përmbarimore të sipërmendura, është kërkuar nga kreditorët zbatimi i kamatës prej 8 % në vit. Të njëjtat propozime i ka lejuar me Urdhër Përmbarimor. Në të dy rastet kundër Urdhrit Përmbarimor ka paraqitur prapësime debitori – tani pala ankuese KS “INSIG”, të cilat prapësime i ka refuzuar si të pabazë Gjykata Themelore në Prishtinë. Ka shtuar më tutje se tanimë lënda është në Gjykatën e Apelit të Kosovës në kompetencë për vendosje në ankesat e debitorit dhe ende nuk ka ndonjë njoftim se a është vendosur lidhur me ankesat e parashtruara. Sipas përmbaruesit privat, fakti se prapësimet janë refuzuar nga Gjykata Themelore dhe Urdhërat Përmbarimor janë lënë në fuqi, i ka dhënë atij siguri juridike, madje edhe përgjegjësinë që të ekzekutoj Urdhrat Përmbarimorë, dhe se nuk do të duhej të konsiderohej se bartë ndonjë përgjegjësi disiplinore. Përmbaruesi ka shtuar se Gjykata e bënë kontrollin e ligjshmërisë së punës dhe akteve të lëshuara nga përmbaruesi privat, andaj, vërtetimi i Urdhrit Përmbarimor me vendim gjyqësor e liron atë nga përgjegjësia disiplinore.

Në seancën për këshilim dhe votim, Komisioni me shumicë votash ka ardhur në përfundimin se përmbaruesi privat është përgjegjës për veprën disiplinore me të cilën është ngarkuar dhe se duhet t'i shqiptohet njëra nga masat disiplinore të parapara me ligj.

Me nenin 22 të LPP-së është paraparë se vendimi i gjykatës mund të jetë dokument përmbarimor. Ky nen, është plotësuar më tutje me nenin 23 të LPP-së i cili ka përcaktuar se:

“Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësore konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”.

Nga provat e administruara, Komisioni ka konstatuar se përmbaruesi privat ka ekzekutuar dy aktgjykime të formës së prerë dhe të plotëfuqishme të gjykatës, si tituj përmbarimor. Mirëpo, me aktgjykimet si tituj përmbarimor, është gjykuar kamata sipas deponimit të mjeteve financiare në bankat afariste në Kosovë, në periudhën një vjeçare të deponimit, pa destinim të caktuar, ndërsa përmbaruesi privat ka zbatuar kamatën e vonesës prej 8 % në vit. Sipas vlerësimit të Komisionit, përmbaruesi privat e ka tejkaluar titujt përmbarimorë, dhe ka bërë shkelje të nenit 22 dhe 23 të LPP-së.

Me nenin 367, paragrafi 1, nënparagradi 1.1. dhe 1.2. të LPP-së është përcaktuar se shkeljet disiplinore mund të jenë si në vijim:

- Nëse përmbaruesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;
- Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij, përmbaruesi privat nuk i përbahet Ligjit.

Sipas vlerësimit të Komisionit, përmbaruesi privat ka shkelur edhe nenin 367, paragrafi 1, nënparagradi 1.1. dhe 1.2. të LPP-së, për shkak të tejkalimit të aktgjykimeve, si tituj përmbarimor dhe dëmtimit të palës debitore "KS INSIG". Komisioni e ka shqyrtuar edhe pretendimin e përmbaruesit privat se Urdhrat Përmbarimor në procedurën e shqyrtimit të prapësimeve, janë lënë në fuqi nga Gjykata Themelore në Prishtinë, mirëpo Komisioni Disiplinor është i pavarur në shqyrtimin e provave të lëndës, e po ashtu i pavarur edhe në vlerësimin e përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit privat. Vendimi i Gjykatës Themelore në këtë rast, është vetëm njëra nga provat e lëndës. Përveç kësaj, Komisioni potencon se vendimi i Gjykatës Themelore nuk është përfundimtar, pasi lidhur me çështjen do të vendos edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, në procedurë ankimore. Komisioni potencon edhe njëherë se është a qartë se përmbaruesi privat ka tejkaluar akgjykimet e forms së prerë – si tituj përmbarimor, gjë që nuk do të duhej të ndodhte në praktikën përmbarimore të përmbaruesit privat.

Në përcaktimin e masës disiplinore, Komisioni ka marrë për bazë peshën dhe natyrën e shkeljes disiplinore, pasojat që ka prodhuar tek pala debitore, faktin se përmbaruesi është treguar i sinqertë dhe bashkëpunues me Komisionin, si dhe faktin se shkeljet e njëjta kanë të bëjnë me dy lëndë përmbarimore, P.nr.251/17 dhe P.nr.24/18. Përkundër ankesave të parashtruara nga debitori – pala ankuese K.S "INSIG", përmbaruesi privat nuk ka ndërmarrë masa të eliminimit të këtyre shkeljeve dhe riparimit të dëmeve të shkaktuara.

Duke u bazuar në këto fakte dhe rrethanat e lartpërmnedura, Komisioni ka ardhur në përfundimin se masë adekuate disiplinore për rastin konkret është gjoba. Me nenin 368, paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së, "gjoba në të holla" është paraparë si masë disiplinore e cila sipas të njëjtës dispozitë mund të jetë nga shuma prej 500 € deri në shumën prej 3000 €. Komisioni, po ashtu ka ardhur në përfundimin se lartësia e gjobës prej 1,000.00 €, është e mjaftueshme për parandalimin e përmbaruesit privat që në të ardhmen të jetë më i kujdeshëm në përbushjen e mandatit të tij ligjor, si përmbarues privat. Andaj, duke marrë për bazë natyrën e shkeljes disiplinore, peshën dhe pasojat e saj, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të larpërmendura, Komisioni vendosi që përmbaruesit privat t'i shqiptojë masën disiplinore "gjobë në të holla", në shumën prej 1,000.00 €, e paraparë me nenin 368, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, me bindjen se kjo masë do të arrijë efektin e duhur në veprimtarinë e mëtejshme profesionale të përmbaruesit privat.

Duke u bazuar në të faktet dhe rrëthanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
Nr. 12/2018, me datën 18.10.2018

Kryesuesi i Komisionit Disiplinor,
Bajram Miftari



UDHËZIMI JURIDIK: Vendimi i Komisionit Disiplinor për Përbaruesit Privat është përfundimtar. Kundër tij mund të ngritet konflikti administrativ (Neni 374.5 i LPP-së).